



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primaleno Mbi/Dana: 23.12.2016

Nr. i organit / Org. broj	Numri/Broj	Shitja / Prilog	Letra / Vrasime
01-013/1211			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008, nenit 5.1.1 të Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 04/L-012 dhe nenit 36, paragrafi 36. 2 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, nenit 9.1.7 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-së, 03/2009 MAPL-së për këshillat komunale për siguri në bashkësi, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më 21.12.2016, miraton këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e Planit të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2017 për Komunën e Vitisë

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Vitisë aprovon Planin e punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2017 për Komunën e Vitisë.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2017 për Komunën e Vitisë, me Nr. 02-07/1630, i datës 09.12.2016.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi dhe planit të punës së KKS-së, do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit,
2. Shërbimit të Kuvendit,
3. MAPL-së, dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Naïm Pira

